VENDIM
Nr.15, datë 10.1.2007

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.646, DATË 12.12.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E STANDARDEVE DHE TË KUSHTEVE TEKNIKE, TË PROJEKTIMIT DHE TË ZBATIMIT, NË FUSHAT E INDUSTRISË DHE TË ENERGJETIKËS, TË CILAT DUHET TË MARRIN STATUSIN "RREGULLA TEKNIKE", TË DETYRUESHME PËR ZBATIM", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr.8464, datë 11.3.1999 "Për standardizimin", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet vendimit nr.646, datë 12.12.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet dhe shtesat, sipas lidhjes, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja

VAZHDIM I LIDHJES NR.1 TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.646, DATË 12.12.2002, I NDRYSHUAR

Lista e standardeve të detyrueshme aktualisht në fuqi, që miratohen në "Rregulla teknike" të detyrueshme për zbatim:

Kreu 1: Naftë, gaz dhe produkte nafte;

Pika 2 ndryshohet, si më poshtë:

Nr.	**Emërtimi**	**Kërkesat themelore të standardeve shqiptare ose standardeve të barazvlefshme me to**
2	Lëndë djegëse për automjete, për përdorim shtëpiak dhe industrial – G.L.N.(Mishelë) – Kërkesat dhe metodat e provës.	SSH EN 589: 2004/AC -Niveli i avujve të presuar, min.150 kPa, në temperaturën sipas grupeve A, B,C, D. -Përmbajtja e përgjithshme e dieneve (duke përfshirë 1.3 butadiene) -Sulfuri i hidrogjenit (H_2S) -Mbetja pas avullimit

Pas pikës 23 shtohet pika 23/1, si më poshtë:

Nr.	**Emërtimi**	**Kërkesat themelore të standardeve shqiptare ose standardeve të barazvlefshme me to**
23/1	Produkte nafte – Lëndë djegëse (klasa F) – gaze të lëngët nga nafta propan dhe butan – Specifikimet.	SSH ISO 9162: 1989 -Për propanin: -C_4 ,%(molar), max -Për butanin: -Hydrokarburet C_5, % (molar), max. -Për propanin dhe butanin: -Dienet, % (molar), max. -Sulfuri i hidrogjenit (H_2S).